

STATISTIKAT E PAGAVE

Tremujori II 2026

Në tremujorin e dytë të vitit 2026, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri ishte 92.150 lekë. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2025, paga mesatare mujore bruto është rritur me 9,8 %.

Pagat sipas aktiviteteve ekonomike NVE rev. 2

Aktivitetet ekonomike me pagë mesatare më të lartë se mesatarja kombëtare janë:

- Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit, me pagë mesatare 187.267 lekë;
- Informacioni dhe Komunikacioni, me pagë mesatare 143.528 lekë.

Rritja më e lartë e pagës mesatare është shënuar në aktivitetin "Ndërtim", prej 22,1 %, ndërsa rritja më e ulët është shënuar në aktivitetin "Arte, argëtim dhe çlodhje, si dhe aktivitete të tjera shërbimi", prej 6,4 %.

Pagat sipas grup profesioneve ISCO-08

Profesionet me pagë mesatare më të lartë se mesatarja kombëtare janë:


- Menaxherë, Ligjvënës, Drejtorë ekzekutivë, me pagë mesatare 141.168 lekë;
- Specialistë me arsim të lartë (profesionistë), me pagë mesatare 119.152 lekë.

Rritja më e madhe e pagës mesatare është shënuar në profesionet "Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to" prej 16,0 %, të ndjekura nga "Punëtorët (Profesione elementare)" prej 15,1 %.


Shpërndarja e të punësuarve sipas nivelit të pagës

Gjatë tremujorit të dytë 2026 vihet re:

- Shpërndarja e të punësuarve vijon të mbetet e përqendruar në skajet e intervaleve të pagave. Punonjësit me pagë minimale përbëjnë 25,8 % të të punësuarve me pagë, ndërsa kategoria e pagave të larta (Mbi 120.000 lekë) pëson rritje të mëtejshme duke arritur në 17,1 %.
- Krahasuar me tremujorin e parë, u rrit numri i të punësuarve me paga të mesme dhe të larta, ku grupi prej 60.001 deri në 120.000 lekë zuri përqindjen më të madhe.

FIG.1 PAGA MESATARE MUJORE BRUTO PËR NJË TË PUNËSUAR ME PAGË (LEKË)¹

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

FIG.2 SHPËRNDARJA E TË PUNËSUARVE ME PAGË SIPAS GRUPEVE TË PAGËS MESATARE MUJORE BRUTO

*) Shënim: Paga minimale në vend ka qenë 26.000 lekë gjatë vitit 2020, 30.000–34.000 lekë gjatë periudhës 2021–2023, 40.000 lekë gjatë periudhës T2 2023–T4 2025 dhe 50.000 lekë nga T1 2026 e në vijim.

Burimi i informacionit: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kontribuesit në Sigurime Shoqërore; Llogaritje të INSTAT

Shënim për përdoruesit:

- Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Pagat](#)
- Në zbatim të Politikës së Trajtimit të Gabimeve, INSTAT ndërmerr pa vonesë korrigjimin e çdo gabimi të identifikuar në statistikatat zyrtare të publikuara. Përdoruesit informohen në mënyrë të menjëhershme dhe transparente për korrigjimet dhe ndryshimet e reflektuara, në përputhje me parimet e paanshmërisë, transparencës dhe cilësisë së statistikave zyrtare. Politika e plotë e Trajtimit të Gabimeve është e disponueshme në adresën: <https://www.instat.gov.al/media/9577/politika-e-trajtimit-te-gabimeve.pdf>

¹Shpërblimet dhe shtesat mbi pagë janë një pjesë e pagës mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, të cilat në fund të çdo gjashtëmujori rrisin ndjeshëm pagën mesatare mujore bruto (shih shënimin metodologjik).

Metodologjia

Publikimi i të dhënave për pagat paraqet informacion të detajuar mbi nivelin, shpërndarjen dhe ndryshimet e pagave ndërmjet tremujorëve, duke mundësuar krahasime mes industrive dhe grupeve të profesioneve. Këto statistika janë të rëndësishme për monitorimin e treguesve ekonomikë dhe ndihmojnë politikëbërësit, punëdhënësit dhe sindikatat në vlerësimin e kushteve të kërkesës dhe ofertës në tregun e punës.

Burimi i të dhënave për statistikën e pagave është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit, i dërgon INSTAT-it, të dhënat administrative nga Listëpagesa (E-SIG 025). Ky formular shërben për deklarimin e tre llojeve të detyrimeve tatimore :

- Të Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore,
- Të Kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore,
- Të Ardhurave nga Punësimi për punëmarrësit.

Variablat e skedarit janë tre lloje: variablat e skedarit origjinal nga DPT, variabla shtesë nga INSTAT dhe variabla të derivuar. Variablat shtesë përfshijnë aktivitetin ekonomik kryesor dhe madhësinë e ndërmarrjes, ndërsa variablat e derivuar lidhen me kategorinë e punësimit dhe profesionin. Qëllimi është të mundësohet analiza më e detajuar e strukturës së punësimit dhe pagave. Dy variablat kryesorë të interesit në këtë skedar janë Numri i punonjësve dhe Paga mujore bruto e paguar nga punëmarrësit.

Përkufizime

Paga mesatare mujore

Në llogaritjen e pagës mesatare mujore bruto përfshihen vetëm të punësuarit kontribues me pagë që kanë punuar 18 ditë ose më shumë gjatë muajit referencë. Këta kontribues përfshijnë të gjitha aktivitetet ekonomike, përfshirë bujqësinë, pyjet dhe peshkimin, të deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Paga mesatare mujore bruto përbëhet nga:

- Shtesa mbi pagë për funksione drejtuese,
- Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë,
- Shtesa mbi pagë për vështirësi në punë,
- Shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.),
- Shpërblime.

Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Mediana e pagës mujore bruto - është paga mesatare mujore në mes të shpërndarjes së pagave.

Paga reale - është paga nominale e rregulluar me nivelin e ndryshimit të çmimeve.

Paga minimale mujore - është paga më e ulët e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Klasifikime

- Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE rev. 2, si më poshtë:

NVE Rev.2 (Seksioni)	Përshkrimi
A	Bujqësia, pyjet, peshkimi
B	Industria nxjerrëse
C	Përpunimi
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve
F	Ndërtimi
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave
H	Transporti dhe magazinimi
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor
J	Informacioni dhe komunikacioni
K	Aktivitete financiare dhe të sigurimit
L	Aktivitete të pasurive të paluajtshme
M	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse
O	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm
P	Arsimi
Q	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale
R	Arte, argëtim dhe çlodhje
S	Aktivitete të tjera shërbimi
T	Aktivitetet e familjeve si punëdhënës; Aktivitete të prodhimit të mallrave e shërbimeve të pandryshueshme të familjeve për përdorimin e vet
U	Aktivitete të organizatave dhe organizmave ndërkombëtare

- Klasifikimi i profesioneve është bërë sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Profesioneve, ISCO-08, si më poshtë:

ISCO_08	Përshkrimi
1	Menaxher
2	Specialistë me arsim të lartë (profesionistë)
3	Teknikë dhe specialistë në zbatim
4	Nëpunësit
5	Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve
6	Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit
7	Zejtarë, artizanë dhe profesione të lidhura me to
8	Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve
9	Punëtorët (Profesione elementare) prej
0	Forcat e Armatosura